



Pranimar / Dorezuar Prilazje / Prilazje Received / Delivery		30. 04. 2021		1 viti god year	
Organ / Agjencia Organ / Udhëheqja Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pritje Appendix	Sasia Koliciteti Quantity		
SKMSTHQ	2161/2021		1/3		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.148/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.148/2021 të datës 17.03.2021, të parashtruar nga ankuesi (grup ankuesish) të cilët me autorizim i përfaqëson avokati, Shefqet Ibrahimimi me adresë Rr. "18 Qershori" pn, Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.148/2021 të datës 17.03.2021 të parashtruar nga ankuesi dhe të tjerët (grup ankuesish) të cilët me autorizim i përfaqëson avokati

A r s y e t i m

Ankuesit

te punësuarë në Shtëpinë e Komunitetit në Skenderaj, me datë 17.03.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokatit kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 1196/2021 të regjistruar me numër A.nr.148/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për realizimin e pagesës shtesë sipas Pakos Emergjente Covid-19, bazuar në Vendimin Nr.31/2020 të datës 03.04.2020 të Qeverisë së Republike se Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.03.2021, ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Skenderajt. Këshilli, me datë 01.04.2021 ka pranua përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1196/2021 të regjistruar me numër A.nr.148/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 09.03.2021; Ankesën e parashtruar nga ankuesit në Komisionin për Parashtrësia dhe Ankesa; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1294/2021 të datës 12.03.2021; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1522/2021 të datës 01.04.2021; Vendimin e datës 03.04.2020; Planin operacional për pakon fiskale emergjente të përberë nga 15 faqe; Kërkesën me numër 02-120/01-0014831/20 të datës 15.05.2020; Listën e Pagave për ankuesit për periudhën kohore 01.05.2020 deri në periudhën kohore 31.05.2020; Aktin e emërimit me numër 854 i datës 11.06.2012 të ankuesit Aktin e emërimit me numër të protokollit 878 të datës 11.06.2012 si dhe Përshkrimi i detyrave të punës së ankueses

Aktin e emërimit me numër të protokollit 139 të datës 24.02.2014 të ankueses

Ndryshimin dhe plotësimin e akt-it të emërimit me numër të protokollit 02-112/01-0012343/2018 të datës 01.03.2018 të ankueses Kontrata e Marrëdhënies së Punës

me numër 02-111/01-0024854/2019 të datës 02.05.2019; Aktin e emërimit me numër të protokollit 154 të datës 14.03.2019 të ankueses Akt Emërimit me numër të protokollit 31 si dhe

përshkrimin e detyrave të punës të datës 21.02.2014 së nëpunës Kontratën e marrëdhënies së punës me numër 02-112/01-0058546/17 të datës 24.10.2017 së ankuese

Aktin e Emërimit me numër të protokollit 841 të datës 11.06.2012 të ankuesit

Aktin e Emërimit me numër të protokollit 905 të datës 11.06.2012 të ankuesit

Aktin e Emërimit me numër të protokollit 904 të datës 11.06.2012 të ankuesit

Aktin e Emërimit me numër të protokollit 903 të datës 11.06.2012 të ankuesit Aktin e

Emërimit me numër të protokollit 902 të datës 11.06.2012 së ankueses Aktin e

Emërimit me numër të protokollit 841 të datës 11.06.2012 të ankuesit Planin e

punës për periudhën kohore 01.01.2011 deri me 31.12.2011 të ankueses Emalin me

numër të protokollit 1818/2021 të datës 16.04.2021; Aktin e Emërimit me numër të protokollit 858 të datës 11.06.2012 të ankuesit Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër 02-

112/01-0055198/20 të datës 30.12.2020 të ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën A.nr.148/2021 të datës 17.03.2021, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Shtëpinë e Komunitetit në Skenderaj.

Kolegji, lidhur me pranueshmërinë e ankesës ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil* - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, si dhe paragrafin 4 ku përcaktohet se: *Nëpunës i Shërbimit Publik* - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta



për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në provat e administruara, gjegjësisht kontratën/akt emërimit e punës të ankuesve, ka konstatuar se ankuesit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, por të njëjtit e kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.148/2021 e datës 17.03.2021 të parashtruar nga Zaim Mehmeti dhe të tjerët (grup ankuesish), te cilët me autorizim i përfaqëson avokati

Në vështrim të nenit 64 dhe 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, marrëdhënia e punës e nëpunësve të shërbimit publikë si dhe nëpunësve administrativo-technik dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, andaj pas konstatimit se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me këtë ankesë, te njëjtit udhëzohen për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.148/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve, avokatit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së;

